

2 110 343/10

Në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 3, neni 8 paragrafi 1 alineja 6, neni 8-a paragrafi 1 alineja 2, 8-b dhe 8-v të Ligjit të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 37/06, 142/08, 148/09, 69/13, 120/13, 148/13, 41/14, 30/16 dhe 64/18), dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.74/25), neni 26, neni 27 paragrafi 4, neni 53 dhe neni 54 paragrafi 4 të Ligjit për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional në shkollat fillore dhe të mesme ("Gazeta Zyrtare e RMV", nr. 161/19), neni 2 i Rregullores për formularin e aplikimit për pjesëmarrje në një shpallje publike për përzgjedhjen dhe akreditimin e programeve për trajnime dhe ofertues të shërbimeve për aftësimin profesional të kuadrit edukativo-arsimor në shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 96/21), Plan i Vjetor i punës së Byrosë për vitin 2026 nr. 01-160/2 nga 27.01.2026, Programi për trajnim për aftësim profesional të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme për vitin 2026 ("Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 29/26, prej 12.02.2026), dhe Programi për trajnime për aftësim profesional të bashkëpunëtorëve profesional ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 30/26 më 13.02.2026) miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës, neni 2 paragrafi 1 pika 2 dhe paragrafi 2 dhe neni 3 nga Rregullorja për përzgjedhjen dhe akreditimin e programit për trajnime dhe ofertuesve të shërbimeve për aftësimin e kuadrit edukativo-arsimor mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional) në shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut nr. 01-333/5 më 22.4.2025. Byroja e Zhvillimit të Arsimit, publikon

SHPALLJE PUBLIKE

për përzgjedhjen dhe akreditimin e programit me përparësi për trajnime dhe ofertuesve të shërbimeve për aftësimin profesional të bashkëpunëtorëve profesional në shkollat e fillore

Byroja e Zhvillimit të Arsimit publikon shpallje publike për akreditimin e një programi me përparësi trajnimi dhe të një ofruesi të shërbimeve për zhvillim profesional të bashkëpunëtorëve profesional në shkollat fillore me temën vijuese:

Trajnim i avancuar për metodat, teknikat dhe instrumentet për këshillim në karrierë dhe orientim profesional të nxënësve (*program me përparësi*).

Të interesuarit duhet të përgatisin dhe dorëzojnë një program për realizimin e trajnimit në kohëzgjatje prej 10 orësh, të shpërndarë në 2 ditë me nga 5 orë, për bashkëpunëtorë profesionalë në shkollat fillore për temën e lartpërmendur, si dhe versionin e programit për Katalog.

Kusht për pjesëmarrje në procedurën e përzgjedhjes dhe akreditimit të programeve të trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve për aftësim profesional të bashkëpunëtorëve profesionalë në shkollat fillore është që të plotësohen kriteret për të cilat kërkohen dokumentet në vijim:

1. Dokument për veprimtari të regjistruar i lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
2. Gjendje aktuale e lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
3. Bilanci i gjendjes dhe bilanci i suksesit i lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
4. Vërtetim se nuk është hapur procedurë falimentimi, i lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
5. Vërtetim se nuk është hapur procedurë likuidimi nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

6. Vërtetim për taksa, kontribute dhe detyrime të tjera publike të paguara, i lëshuar nga Drejtoria e të Ardhurave Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
7. Vërtetim nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga Regjistri i dënimeve për vepra penale të personave juridikë, se nuk i është shqiptuar dënim plotësues ndalim i përkohshëm ose i përhershëm për ushtrimin e një veprimtarie të caktuar.
8. Vërtetim se me vendim të formës së prerë nuk i është shqiptuar sanksion kundërvajtës për ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, përkatësisht ndalim i përkohshëm për ushtrimin e një veprimtarie të caktuar, i lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
9. Vërtetim nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga Regjistri i dënimeve për vepra penale të personave juridikë, se nuk i është shqiptuar dënim plotësues ndalim për pjesëmarrje në procedura të thirrjeve publike, dhënies së kontratave të prokurimit publik dhe kontratave për partneritet publiko-privat.
10. Deklaratë se ka përvojë në realizimin e trajnimeve për zhvillim profesional, me informacione më të detajuara si dëshmi se ka realizuar të paktën tre trajnime për mësimdhënës/bashkëpunëtorë profesionalë në arsimin formal në tema të ndryshme gjatë pesë viteve të fundit, deri në ditën e publikimit të shpalljes. Deklarata duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga personi i autorizuar i ofruesit dhe e mbështetur me dëshmi (kontratë, vërtetim etj.).
11. Deklaratë se ofruesi do të sigurojë hapësira të përshtatshme për mbajtjen e trajnimit për mësimdhënës – këshilltarë të karrierës, të përshtatura për grupe deri në 25 pjesëmarrës, me dy trajnerë për grup dhe me kushte të siguruara (sallë konferencash me projektor, sistem audio, tavolina dhe karrige për punë, qasje në internet dhe hapësira sanitare, si dhe akomodim me pension të plotë për 2 net për pjesëmarrës). Trajnimi mund të realizohet në disa grupe, në një ose më shumë hotele dhe qytete, sipas nevojave të programit.
12. Listë dhe biografi (CV) të të paktën 40 trajnuesve në nivel shtetëror për fushën përkatëse, të cilët:
 - kanë të paktën nivel arsimor VII/1 ose 240 kredi SETK, që dëshmohet me kopje diplome ose vërtetimi për arsim të përfunduar dhe kanë mbajtur të paktën dy trajnime nga fusha përkatëse, që dëshmohet me vërtetim ose rekomandim origjinal për trajnime të realizuara nga institucioni/kompania për të cilën është kryer shërbimi; ose
 - janë ligjërues në të paktën një program studimi nga fusha përkatëse, që dëshmohet me vërtetim origjinal të lëshuar nga institucioni ku janë të punësuar dhe/ose të angazhuar.
13. Deklarata nga trajnerët se janë dakord të realizojnë trajnimet konkrete.

Me dokumentin nga pika 1, ofruesi i shërbimit dëshmon se është i regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë të paktën pesë vjet para datës së publikimit të shpalljes publike.

Me dokumentin nga pika 3, ofruesi i shërbimit dëshmon se ka të ardhura minimale të përgjithshme prej 6.000.000 denarë në tre vitet e fundit.

Kriteret e mësipërme janë eliminatore.

Personi zyrtar i autorizuar nga Byroja që e udhëheq procedurën, brenda tre ditëve nga pranimi i aplikimit, sipas detyrës zyrtare do të kërkojë dokumentacionin nga pikat 1,2,3,4,5,6,7,8 dhe 9 nga organet kompetente.

Dokumentet nga pikat 10, 11, 12 dhe 13 përgatiten, nënshkruhen dhe vulosen nga personi përgjegjës i ofruesit.

Ofruesi duhet të dorëzojë program për akreditim për temën konkrete nga shpallja publike, sipas kriterëve të përcaktuara në dokumentacionin e shpalljes;

Ofertuesi duhet të dorëzojë ofertë për çmim të pjesëmarrësit në pajtim me kriteret e caktuara në dokumentimin e shpalljes

Kriteret për vlerësimin e ofertave

- Çmimi për bashkëpunëtor profesional - 30 pikë.
- Përmbajtja e programit të ofruar - 60 pikë.
- Ndjekja e efekteve të trajnimit - 10 pikë.

Trajnimet për bashkëpunëtorët profesional do të realizohen në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe. Ato do të organizohen në grupe me maksimum 25 pjesëmarrës, përmes aktiviteteve të bazuara në metoda interaktive dhe të nxënësve përmes përvijës. Fillimi i realizimit të trajnimeve është planifikuar nga maji i vitit 2026.

Mjetet për realizimin e trajnimeve janë siguruar përmes Projektit për përmirësimin e arsimit fillor mbështetur nga Banka Botërore.

Byroja e Zhvillimit të Arsimit miraton Vendim për akreditimin e programit të trajnimit dhe të ofruesit të shërbimeve, me vlefshmëri tre (3) vjet.

Byroja do të lidhë kontratë me ofruesin e përzgjedhur për realizimin e trajnimit për (rreth 900) bashkëpunëtorë profesional nga shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Me kontratën do të përcaktohet qartë dinamika e zbatimit të trajnimit.

Shpallja publike zgjat 20 ditë, duke përfshirë edhe ditën e publikimit.

Hapja publike e ofertave do të mbahet në ambientet e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, rr. "Rugjer Boshkoviq" nr. 20, Shkup, më **30.03.2026 në orën 11:00.**

Afati për dorëzimin e dokumentacionit në arkivin e Byrosë është **30.03.2026 deri në orën 10:30.**

Aplikimet me dokumentacion të paplotë ose të pavlefshëm, si dhe ato të dorëzuara me vonë, nuk do të shqyrtohen.

Dokumentacioni i nevojshëm për pjesëmarrje në shpalljen publike mund të merret: në arkivin e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, ose nga faqja e internetit: www.bro.gov.mk

Në hapjen publike të ofertave mund të marrin pjesë përfaqësues të pjesëmarrësve të interesuar me autorizim me shkrim, të vulosur dhe të nënshkruar nga personi përgjegjës.

Si ofrues të programeve të trajnimit dhe shërbimeve për zhvillim profesional të mësimdhënësve – këshilltarë të karrierës në shkollat e mesme mund të aplikojnë: institucione publike dhe private, shoqata të qytetarëve, shoqëri tregtare.

Ofruesit mund të aplikojnë individualisht ose të bashkohen në një grup ofruesish për të paraqitur një ofertë të përbashkët.

Në këtë shpallje nuk mund të aplikojnë, as si ofrues shërbimesh dhe as si trajnerë të angazhuar, personat e punësuar në: Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Byronë e Zhvillimit të Arsimit, Qendrën Shtetërore të Provimeve, Qendrën për Arsimin e të Rriturve, Qendrën për Zhvillimin e Arsimit Profesional, Inspektoratin Shtetëror të Arsimit, drejtorët e shkollave.

Të interesuarit mund të parashtrojnë pyetje në formë elektronike më së voni 3 ditë para hapjes publike të ofertave në emailin: bro.macedonia@bro.gov.mk me shënimin: "Për Komisionin për përzgjedhje dhe akreditim të programeve të trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve për stafin edukativo-arsimor (mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesionalë) në shkollat e mesme."

Byroja e Zhvillimit të Arsimit

